

Fuqizimi i infrastrukturës së TIK ut nëpër Komuna Projekti I

Softueri dhe përkrahja për Integrimin e zyrave të Kuvendeve Komunale për shërbim të qytetarëve me portalin ministror . Projekti II

Trajnimi i 400 shërbyesve Civil sipas programit ECDL (european Comuter Driving Licence)

Ky projekt synon që të formojë infrastrukturën bazë për Interkonektimin e Zyrave për Shërbim të qytetarëve (ndodhen në çdo komunë të Republikës së Kosovës) Në nivel të shënimeve dhe Aplikacioneve të duhura me MAPL –në. Formimin e Indikatorit të Performancës për Administratë dhe Asambletë komunale. Inkorporimin e elementeve të softuerit në Web Faqet Komunale që ti mundësohet qytetarit, qasja përmes internetit në përcjelljen e statusit të lëndës që ka dorëzuar në administratën Komunale.

Të mirat që sjellë realizimi i projektit:

- **Ritet kualiteti i shërbimeve**, qytetari përmes internetit ka mundësi ta përcjellë Lëndën e dorëzuar, statusin e lëndës, qasjen në dokumenta apo informacione të publikuara në WEB server të Komunës. Me pajisje të qytetarëve me letërnjoftim inteligjent (smartcard), si dhe kontura Ligjore adekuate mundëson Qytetarët të nënshkruhen nga distanca, në mënyrë Unike dhe të sigurtë. Krahas kësaj shumë shërbime mundë të kryhen nga distanca pa pasur nevojë që qytetari ta vizitojë ndërtesën e Komunës.
- **Ritet efikasiteti i menagjimit**, me formimin e databazës qendrore, nëpër Komuna, menjanohet redundanca e shënimeve, si dhe shkëputja mediale. Kjo mundëson që vendimarrja të përkrahët me shënime korekte, aktuale Pa redundancë, në çdo kohë, nga secili vendë që ka qasje në Internet.
- **Ritet Besueshmëria**, Infrastruktura e paraparë , përmirson rrjedhjen e informacioneve , shpejtë saktë dhe sigurtë. Transparenca me angazhimin aktiv të qytetarëve formon besueshmëri në mes të Qytetarëve dhe Qeverisë.
- **Transformohen shërbimet**, Duke mundësuar që shërbimet të jenë më të qasëshme, dhe më të përshtatshme për qytetarët . I mundësohet njerëzve me aftësi të kufizuara, një lehtësi e madhe.
- **Rritet Demokracia**, Komunitat bëhen më të hapura, më të përgjegjshme, e-qeverisja mundë ti rritë mundësitë e komunikimit në mes të qytetarëve reth temave të caktuara, mundëson involvimin e qytetarëve gjatë vendimarrjes.